



Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



Kosovo Local
Government
Institute

UDHËZUESI PËR HARTIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL

Aktiviteti realizohet në kuadrin e programit 'Dialogu për Komunitat Evropiane' (DEM), i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë.



Norwegian Embassy

DEM
Dialogue for European Municipalities

Përmbajtja

<u>I. LISTA E HAPAVE PËR HARTIMIN DHE PËRFUNDIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL</u>	3
<u>1.1 GRUPI PUNUES</u>	4
<u>1.2 TAKIMET PUBLIKE</u>	5
<u>1.3 ANALIZA</u>	5
<u>1.4 KONSULTIMI</u>	6
<u>1.5 ANALIZA PAS-KONSULTIMIT</u>	7
<u>1.6 APROVIMI I STRATEGJISË</u>	7
<u>II. UDHËZIMET PËR HARTIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL</u> ..	8
<u>2.1 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</u>	9
<u>2.2 HYRJA</u>	10
<u>2.3 METODOLOGJIA</u>	10
<u>2.4 MISIONI DHE VIZIONI</u>	11
<u>2.5 SFONDI</u>	11
<u>2.5.1 Analiza e gjendjes aktuale</u>	12
<u>2.5.2 Përkufizimi i problemit</u>	14
<u>2.5.3 Krahasimi me vendet/komunat të tjera</u>	14
<u>2.5.4 Analiza e problemit dhe mundësive për zgjidhje</u>	15
<u>2.5.5 Përmbledhja e sfidave</u>	17
<u>2.6 OBJEKTIVAT</u>	17
<u>2.6.1 Treguesit/ Aktivitetet</u>	20
<u>2.7 MONITORIMI DHE RAPORTIMI</u>	21
<u>2.8 NDIKIMI BUXHETOR</u>	22

I. LISTA E HAPAVE PËR HARTIMIN DHE PËRFUNDIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL

Aktiviteti	Përshkrimi	Kohëzgjatja e propozuar
HAPI 1: Formimi i grupit punues	Përcaktimi i përbërjes së grupit punues duke përfshirë Kryesuesin e grupit, anëtarët nga departamente relevante të Komunës dhe akterë të ndryshme.	2-4 javë
HAPI 2: Takimi Publik (opcionale)	Diskutim i hapur me palët të interesuara duke përfshirë qytetarët para hartimit të Strategjisë ku çështjet të rëndësishme që duhet të jenë pjesë të Strategjisë përcaktohen.	2 javë
HAPI 3: Analiza	<ul style="list-style-type: none"> ○ Përgatitja e pjesëve përkatëse ○ Mbledhja e të dhënave ○ Diskutimet me grupin punues ○ Konsultimet me palë të ndryshme ○ Analiza e të dhënave të mbledhura ○ Identifikimi i hapave të ardhshme 	12-24 javë
HAPI 4: Konsultimi	Konsultimi i draftit të Strategjisë përmes uebfaqës së Komunës dhe me takime publike me qytetarë.	4-8 javë
HAPI 5: Analiza pas-konsultimit	<ul style="list-style-type: none"> ○ Analiza e komenteve/sugjerimeve nga konsultimet me publikun ○ Përfshirja/mos përfshirja e komenteve në draftin përfundimtar të Strategjisë ○ Raporti i konsultimeve 	2 javë
HAPI 6: Takimi i fundit të Grupit Punues	Finalizimi i Strategjisë dhe dërgimi e saj për aprovim.	1 javë

1.1 GRUPI PUNUES

Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal është një proces i cili kërkon përkushtim nga secili departament të Komunës përgjatë një periudhe nga 6 deri në 8 muaj. Përcaktimi i përbërjes së grupit punues në raste specifike kërkon një kohe prej 2 deri në 4 javë ku departamentet përkatëse të Komunës konsultohen për përcaktimin e stafit si anëtar të grupit. Pozitat si më poshtë *preferohen* të jenë pjesë e grupit punues:

- ✚ Kryesuesi i Grupit Punues
- ✚ Zëvendës Kryesuesi i Grupit Punues
- ✚ Zyrtarë përkatës të politikave nga secili Drejtori:

Drejtoria i Administratës

Drejtoria Ligjore

Drejtoria për Financa dhe Ekonomi

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtoria për Arsim

Drejtoria për Kulturë dhe Rini

Drejtoria i Urbanizmit

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Drejtoria për Shërbime Publike

- ✚ Anëtarë/e nga Sekretariati
- ✚ Anëtarë/e përgjegjës/e për konsultim dhe komunikim
- ✚ Anëtarë/e jashtëm në bazë të ekspertizës

Anëtarë/e nga Organizatat e Shoqërisë Civile

Ekspertët dhe Konsulentët jashtëm

Zyrtarë nga Ministria përkatëse (në raste dhe tema specifike)

1.2 TAKIMET PUBLIKE

Sipas nenit 10 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2018 për Standardet Minimale për Konsultimet Publike në Komuna takimet publike janë takime që organizohen para fillimit të hartimit të Strategjisë. Këto takime kanë për synim të komunikojnë palëve të interesuara objektivat e Komunës për një Strategji të zhvillimit. Këto takime janë hapur për të gjitha palët të interesuara, për qytetarët apo grupe të ndryshme të cilët mendojnë se mund të kontribuojnë në zhvillimin e një Strategjie sa më gjithëpërfshirëse dhe efektive.

Takimet Publike preferohen të mbahen në fillim të procesit të hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal. Anëtari përgjegjës në grupin punues për komunikim duhet të përgatis një thirrje publike për këtë takim ku gjithë përfshirja dhe pjesëmarrja e sa më shumë palëve të interesit do ta ngrit transparencën dhe do të kontribuojë në një proces demokratik të hartimit të dokumentit.

Ftesat për takimet publike duhet të dërgohen së paku 8 dite dhe më së shumti 14 ditë para datës së takimit për të ngritur vizibilitetin dhe të japë sa më shumë hapësirë palëve të interesuara. Të dhënat e mbledhura gjatë këto takime mund të përdoren si pikënisje për hartimin e objektivave të Strategjisë duke e bërë atë në harmoni me kërkesat e qytetarëve që jetojnë në atë komunë.

Takimet publike nuk janë të obligueshme por preferohen të organizohen për të ngritur transparencën dhe gjithë përfshirjen dhe për të kontribuojnë në proceset demokratike të politikë bërjes në Kosovë.

1.3 ANALIZA

Hapi më i rëndësishëm të hartimit të Strategjisë përbëhet nga procesi i analizës i cili zgjat nga 12 deri në 24 javë. Gjatë kësaj periudhe grupi punues duhet të takohet në periudha të përcaktuara për të hartuar pjesët e dokumentit. Përbërja e grupit punues e cila përfshinë anëtarë nga secili drejtori të Komunës e lehtëson edhe procesin e mbledhjes të dhënave e cila është thelbi i hartimit të një Strategjie të mirëfilltë.

Gjatë procesit të analizës grupi punues i përcakton objektivat e përgjithshme dhe objektivat specifike të Strategjisë, diskuton aktivitetet të cilat janë të domosdoshme për arritjen e objektivave, vendos në hapat të rëndësishme për zbatimin e Strategjisë duke operacionalizuar objektivat në plan të veprimit të Strategjisë.

Gjatë procesit të analizës dhe hartimit të dokumentit informimi i grupit punues me kohë për takime të përbashkëta, përfshirja e akterëve të ndryshme jashtëm si p.sh zyrtarë përkatës nga ministrit, ekspertë të jashtëm apo përfaqësues të OJQ-ve apo grupeve të ndryshme për të kontribuar në pjesët specifike të hartimit është e rëndësishme.

Në këtë proces grupi punues po ashtu duhet të vendosë për mënyrën e vlerësimit dhe monitorimit të Strategjisë. Çdo Strategji duhet të monitorohet në periudha tremujore, kurse raporti i vlerësimit të zbatimit vjetor duhet të hartohet deri në fund të tremujorit parë të vitit pasues. Grupi punues në proces të hartimit dhe analizës mund të vendos për raportime dhe monitorime më të shpeshta sipas nevojës.

1.4 KONSULTIMI

Sipas nenin 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2018 për Standardet Minimale për Konsultimet Publike në Komuna, komunat janë të obliguar të ofrojnë konsultime publike për të gjitha dokumentet Strategjike dhe zhvillimore të hartuara nga komuna. Po ashtu, sipas udhëzimit të njëjte në çdo komunë, përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është njësia/zyrtari për komunikim publik¹. Zyrtari/ja përgjegjës për komunikim po ashtu është pjesë e grupit punues për hartimin e Strategjisë.

Sipas nenit 18.1 konsultimi publik zgjat jo më pak se 30 ditë kalendarike dhe jo më shumë se 60 ditë kalendarike nga data e shpalljes së njoftimit publik për mbajtje të konsultimeve. Gjatë procesit të konsultimit zyrtari përgjegjës për konsultim përgatit njoftimin lidhur me formën e konsultimeve dhe e publikon projekt-Strategjinë në uebfaqen e Komunës dhe në Platformën Online të Konsultimeve Publike. Gjatë procesit të konsultimit grupi punues mund të vendos për mbajtjen e takimeve me

¹ Udhëzimit Administrativ nr. 06/2018 për Standardet Minimale për Konsultimet Publike në Komuna

palët e interesit. Në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës për përgatitjen e draftit fillestar të Strategjisë dhe grupin punues, zyrtari për komunikim koordinon organizimin e takimeve të drejtpërdrejta me qytetarë dhe palët e interesuara. Për një proces të konsultimit sa më efektiv dhe efikas një planifikim të mirëfilltë me kohë, organizim i konsultimit sa më gjithëpërfshirës dhe mbledhja e komenteve dhe dërgimi i tyre te grupi punues është e domosdoshme.

1.5 ANALIZA PAS-KONSULTIMIT

Pas përfundimit të konsultimit publik në platformat online dhe takimet publike, zyrtari përgjegjës duhet të përgatis një raport të konsultimit ku të gjitha komentet e dërguara prezantohen grupit punues. Shqyrtimi i komenteve bëhet nga grupi punues i projekt strategjisë i cili vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara.

Sipas nenit 5.5 të udhëzimit administrativ nr. 06/2018, komuna është e obliguar të shpall rezultatet e procesit të konsultimit publik, të publikoj raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët dhe palët të interesit, si dhe të jap sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara.

1.6 APROVIMI I STRATEGJISË

Hapi i fundit të hartimit të Strategjisë përfshinë takimet përfundimtare të grupit punues ku sipas draftit para përfundimtare te dërguar për konsultime publike, grupi punues ka harmonizuar të gjitha komentet dhe sugjerimet e marra. Në këtë takim të fundit, grupi punues vendos që të dërgojë Strategjinë për aprovim.

II. UDHËZIMET PËR HARTIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL

Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit të gjitha institucionet qendrore dhe lokale duhet të përmbahen rregullave të përcaktuara me këtë UA për hartim të dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit. Në këtë mënyre, ky Udhëzim është hartuar për të shërbyer të gjitha komunave të Republikës së Kosovës në hartimin e Strategjive tyre për Zhvillim Ekonomik Lokal. Udhëzimet si më poshtë listojnë të gjitha informatat e domosdoshme që duhet të jenë pjesë e Strategjisë.

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal duhet të përfshijë objektivat afatmesme për 5 vitet e ardhshme, kurse plani i veprimit të Strategjisë duhet të hartohet për një periudhë 3 vjeçare. Strategjia duhet të përfshijë vlerësimin e ndikimit buxhetor si shtojcë bashkë me planin e veprimit. Komuna vendos në mënyrat e vlerësimit dhe monitorimit të Strategjisë.

Udhëzimi për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal, është dokument politikash i MAPL-së me qëllim të përkrahjes së komunave në hartimin e dokumenteve strategjike që ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal dhe një udhërrëfyes për komuna të cilat do të ndihmohen në hartimin e strategjive për zhvillim ekonomik lokal, e cila gjithashtu do të orientoj komunat në realizmin e objektivave të tyre.

2.1 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në këtë pjesë paraqitet natyra e problemit e cila adresohet nga Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal. Gjithashtu listohen objektivat kryesore të dokumentit strategjik dhe me një përmbledhje të shkurtër cekën veprimet e rekomanduara për zgjidhjen e problemit si dhe arsyetimin për këtë qasje.

Komunat duhet të bëjnë përpjekje që përmes zhvillimit ekonomik lokal të përmirësojnë dhe ngritin kualitetin e jetës së qytetarëve duke krijuar mundësi të reja në mirëqenien ekonomike dhe shoqërore. Komunat janë të ndryshme si dhe kapaciteti i tyre për planifikim është i ndryshëm. Kjo do të thotë se secila komunë duhet të zgjedh se çfarë lloji të planifikimit të zhvillimit ekonomik lokal i nevojitet.

Gjatë hartimit të Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal udhëheqësi i ekipit duhet të zbatojë me përpikëri formën dhe përmbajtjen e përshkruar në këtë dokument. Përmbledhja ekzekutive të Strategjisë nuk duhet të jetë më shumë se 3 faqe total dhe duhet të përfshijë të gjitha informacione të listuar si më poshtë:

Pjesa e Përmbledhjes	
Përshkrim i shkurtër të problemit dhe qëllimit kryesor të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal.	Jo më shumë se 3 paragrafë.
Lista e Objektivave Përgjithshme të Strategjisë	Vetëm objektivat e përgjithshme duhet te listohen këtu
Përmbledhja e rekomandimeve të dakorduara për të adresuar problemin	Jo më shumë se 2 paragrafë
Rekomandimet kryesore për secilin sektorë	Jo më shumë se 1 paragrafë për secilin sektor.

Qëllimi i përmbledhjes ekzekutive është të bëjë një shpjegim të shkurtër të të gjitha pikave të Strategjisë, për këtë arsyeje përfshirja e informatave kyçe të Strategjisë dhe përshkrimi i tyre shkurtë do të bëjë edhe Strategjinë më të kuptueshme për lexuesit.

2.2 HYRJJA

Hyrja e Strategjisë nuk duhet të jetë më shumë se një faqe dhe duhet të ketë informata lidhur me arsyet se pse hartohet kjo Strategji, si ndërlidhet me prioritetet e Komunës dhe planet e saj afatmesme dhe referenca në dokumente të ndryshme të cilat paraqesin nevojën për hartimin e një strategjie për zhvillim ekonomik lokal.

Më specifikisht, Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal duhet të referohet në prioritetet e Qeverisë që ndërlidhen me këtë fushë, me Planin Strategjik Afat mesme dhe Afatgjatë të Qeverisë, Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal, dokumente të ndryshme të Komunës të cilat kanë referenca për nevojën e hartimit të një strategjie për zhvillim ekonomik lokal.

Pjesa e hyrjes së strategjisë duhet të jetë sa më e shkurtër dhe teknik, dhe të bëjë ndërlidhjen e saktë me të gjitha dokumente të hartuara paraprakisht. Një plan i qëndrueshëm, i realizueshëm dhe efektiv sigurohet nëse ai bashkërendohet me faktorët e tjerë që ndikojnë në zhvillimin e komunës.

2.3 METODOLOGJIA

Pjesa e metodologjisë së Strategjisë nuk duhet të jetë më shumë se një faqe dhe duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të qasjes analitike të përdorur gjatë procesit të hartimit të Strategjisë. Kjo pjesë po ashtu duhet të përfshijë informata lidhur me të gjitha drejtoritë e Komunës, institucione të ndryshme lokale dhe qendrore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, ekspertët të jashtëm dhe ndonjë pale tjetër të interesuar të cilët kanë qenë pjesë e procesit të hartimit dhe kanë kontribuar në zhvillimin e dokumentit. Të gjitha pikat që duhet të jenë pjesë e metodologjisë më saktësisht janë:

- ✚ Ndërlidhja me dokumentet strategjike
- ✚ Lista e drejtorive të komunës dhe anëtarëve të tjerë pjesë të grupit punues
- ✚ Kontributet e marra gjatë takimit publik të mbajtur në fillim të hartimit
- ✚ Komentet/sugjerimet e marra nga palët e interesit gjatë konsultimeve publike
- ✚ Informata lidhur me qasjen e grupit punues për komentet e marra nga qytetarët
- ✚ Përfshirja e sugjerimeve dhe kërkesave të qytetarëve dhe bizneseve
- ✚ Informata lidhur me analizën e bërë gjatë hartimit të strategjisë nga ekspertët e fushave të ndryshme

Të gjitha pikat e listuar më sipër duhet të jenë pjesë e kapitullit të metodologjisë. Më shumë informata lidhur me pjesën analitike të hartimit të strategjisë po ashtu mund të shtohen në këtë kapitull.

Kapitulli i Metodologjisë duhet të hartohet në fund të hartimit të strategjisë pasi që i njëjti përfshinë të gjitha informata lidhur me hapa të ndërmarra gjatë hartimit të dokumentit.

2.4 MISIONI DHE VIZIONI

Para se të kalohet në kapitullin e sfondit i cili përmban të gjitha informatat lidhur me gjendjen aktuale, problemet kryesore dhe sfidat, Strategjia duhet të jetë informata të shkurtra lidhur me misionin dhe vizionin e komunës në këtë fushë. Misioni dhe vizioni nuk duhet të jetë më shumë se gjysmë faqe në total. Misioni dhe vizioni nuk duhet të përzihen dhe dallimi mes tyre duhet të jetë i qartë dhe mirë kuptueshëm.

Misioni i komunës për zhvillim ekonomik lokal duhet të ndihmojë në vendim-marrjen lidhur me rrugët dhe mënyrat për të arritur ndryshimet që nevojiten për një zhvillim ekonomik sa më efektiv.

Kurse vizioni i komunës ndërlidhet me pritshmërinë dhe aspiratat e komunitetit dhe duhet të përcaktojë një drejtim të qartë të zhvillimit ekonomik lokal.

Më specifikisht, vizioni duhet të fokusohet në të nesërmen dhe atë që një komunë dëshiron të arrijë përfundimisht. Ndërsa misioni duhet të fokusohet në të sotmen dhe atë që një komunë bën për ta arritur atë. Të dyja janë jetike në drejtimin e qëllimeve.

2.5 SFONDI

Sfondi është kapitulli kryesor të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal ku të gjitha analizat e bëra përshkruhen. Analizat dhe informatat e dhëna në pjesën e sfondit janë logjika që e bëjnë përcaktimin e objektivave të përgjithshme dhe atyre specifike të mundshëm. Për këtë rast, të gjitha analizat e bëra në këtë kapitull duhet të jenë sa më të kuptueshëm dhe duhet të përkufizojnë problemin për të japur një logjikë definimit të objektivave strategjike. Sfondi i strategjisë nuk duhet të ketë përkufizime të faqeve por duhet të jepen të gjitha informata të nevojshme në mënyre precize dhe të kuptueshme.

2.5.1 Analiza e gjendjes aktuale

Pjesa e parë e sfondit duhet të ketë një përshkrim të gjendjes aktuale të zhvillimit ekonomik lokal të Komunës. Gjendja aktuale duhet të përfshijë të gjitha informatat lidhur me qeshjet socio-ekonomike të Komunës të cilët duhet të jenë target për përmirësim gjatë zbatimit të Strategjisë. Në këtë nën-kapitull grupi punues duhet të bëjë identifikimin e problemeve dhe shkaqeve të tyre, sfidave dhe mundësive të zgjidhjes së tyre. Sipas manualit për hartimin e dokumenteve strategjike në këtë nën-kapitull duhet të mblidhen dhe të ofrohen argumente mbështetëse lidhur me problemet e identifikuara, sfidat dhe mundësitë nga ekipi hartues që është duke e hartuar dokumentin strategjik. Të dhëna empirike janë çdo fakt, e dhënë ose informacion në dispozicion i cili tregon se a është i vërtetë ose i vlefshëm një besim, gjykim ose propozim.

Gjendja aktuale duhet të përfshijë informata lidhur me situatën socio-ekonomike, demografinë, bizneset, shërbimet publike etj. Për shtrirjen gjeografike duhet pasur parasysh këto referime: koordinatat gjeografike, tip kryesor i zonës (fushore, rrafshnaltë, kodrinore, malore apo pjesë të tyre, etj.); karakteristikat gjeologjike të zonës ku shtrihet komuna; lumenjtë që burojnë ose kalojnë nëpër komunë, liqenet, malet dhe majat më të larta të zonës, ose nëse janë të dallueshme edhe nëse nuk ndodhen në territorin e komunës por afër saj, etj.

Lidhur me popullsinë do të duhej pasqyruar këto të dhëna të nevojshme demografike si: numri i banorëve dhe grafiku i ritmeve të rritjes (ose të rënies së popullsisë). Nëse ka rënie të ritmeve të rritjes përmenden dy ose tre faktorët me përcaktues të këtij fenomeni demografik. Përbërja meshkuj femra; vendi i popullsisë së qendrës së komunës, ndaj popullsisë së gjithë komunës dhe numri i banorëve të gjithë komunës në rajon apo në nivel vendi; përbërja e popullsisë së komunës sipas etnive (pa përjashtuar asnjë grup) dhe për ndonjë grup mund të ipet edhe trendi i rritjes ose zvogëlimit. Përbërja e popullsisë sipas besimit fetar; numri i lindjeve dhe i vdekjeve për 1000 banore, trendi. Saldoja migruese, trendi, 2-3 shkaqe. Raporti i lindjeve meshkuj/femra; struktura e popullsisë sipas grup moshave për vitin më të fundit. Mosha mesatare e popullsisë.

Një pasqyrë e infrastrukturës përmbledh këto të dhëna: gjatësia në kilometra e rrugëve të asfaltuara që përshkojnë komunën. Raporti Km rrugë/Km² sipërfaqe; gjatësia e rrugëve të asfaltuara (mundësisht edhe sipas llojit, me zhavorr, dheu, guri etj.). Raporti km rrugë/Km²sipërfaqe; gjatësia e rrugës hekurudhore që përshkon komunën dhe pikat

fundore të saj; furnizimi me Energji Elektrike (i mire, i mjaftueshëm, i dobët); shtrirja e telekomunikacionit (i mirë, i mjaftueshëm, i dobët).

Duke pasqyruar gjendjen aktuale të ofrimit të shërbimeve publike duhet të elaborohet për secilin shërbim gjendja aktuale dhe pasqyrohet një plan për përmirësimin e gjendjes aktuale për shërbimet si: shërbimet administrative, mirëqenia sociale, kulturë rini dhe sport, planifikimi urban, parqet dhe sheshet, rrugët, trotualet, transporti publik, parkingjet publike, ndriçimi publik, furnizimi me ujë, kanalizimi, grumbullimi i mbeturinave, deponimi i mbeturinave, etj.

Për sektorin e arsimit duhet pasqyruar përmbledhtas të dhënat si : shtrirja e arsimit para fillor, dhe numri i nxënësve, shtrirja e arsimit fillor dhe numri i nxënësve, shtrirja e arsimit të mesëm dhe numri i nxënësve, numri i studenteve në komunë dhe trendet, numri i analfabeteve trendi dhe vendi i tyre në popullsinë e komunës, numri i mësimdhënësve (raporti mësimdhënësve/nxënës dhe raporti mësimdhënësve/ banorë).

Një përmbledhje se cila është gjendja aktuale e shëndetësisë në komunë dhe synimet për një përmirësim të ofrimit të këtij shërbimi si numri i mjekëve për kokë banori, numri i infermierëve për koke banori, numri i vizitave vjetore, numri i shërbimeve të ofruara për të gjitha komunitetet të cilat jetojnë në territorin e komunës.

Trajtimi i punësimit duhet pasqyruar këto të dhëna të nevojshme: vendi i të punësuarve në raport me popullsinë. Punësimi sipas gjinisë, etnitetit dhe moshës. Struktura e të punësuarve: sektori publik, të vetëpunësuar, të punësuar në sektorin privat; vendi i të papunësuarve në raport me popullsinë dhe të punësuarit. Struktura e të papunësuarve sipas grup moshave dhe arsimit; struktura e të punësuarve sipas degëve kryesore: në bujqësi, në agrobiznes, në degë të tjera me karakter industrial, në shërbime, në tregti; struktura e të punësuarve në sektorin publik: në administratë, në shëndetësi, në arsim etj.; vendi i të punësuarve jashtë vendit.

Profili ekonomik i Komunës përmbledh të dhëna si: përmbledhje e karakteristikave kryesore të zhvillimit ekonomik; përmbledhje e tendencave kryesore të zhvillimit ekonomik; drejtimet kryesore të zhvillimit ekonomik si: degë me karakter industrial, zhvillimi i bujqësisë. Struktura e administrimit të tokës. Sistemet e kanalizimeve dhe ujitjes së tokës; sipërfaqet e kulturave kryesore. Trende, ndryshimi; përpunimi i produkteve bujqësore; zhvillimi i turizmit; zhvillimi blegtorisë; zhvillimi i pylltarisë;

zhvillimi i sektorit privat dhe komunitetit të biznesit; shkalla e organizimit në shoqata; struktura e ndërmarrjeve dhe prodhimit; sektori publik; sektori privat.

Qeverisja komunale përmbledhet në të dhënat: struktura dhe organogrami i administratës komunale; struktura dhe përbërja e komisioneve të Kuvendit Komunal; të ardhurat dhe shpenzimet komunale, para hartimit të SZHEL-së; tregues të tjerë të menaxhimit në Komunë (projekte dhe bashkëpunime me donatorë që janë në proces).

Kjo pjesë është kyçe në identifikimin e objektivave dhe përcaktimin e aktiviteteve/masave për këtë arsyeje analizat dhe të dhënat e mbledhura në këtë fazë duhet të jenë sa më të kuptueshme.

2.5.2 Përkufizimi i problemit

Pjesa e dytë e sfondit duhet të përfshijë përkufizimin e problemit. Përkufizimi i problemit duhet të hartohen nga grupi punues por në raste specifike kontributi i palëve të tjerë si p.sh. ekspertët të jashtëm a po organizata të shoqërisë civile po ashtu duhet të jetë pjesë e procesit. Sipas manualit për hartimin e dokumenteve strategjike çfarëdo forme apo metode që zgjidhet për analizë (e brendshme ose e kontraktuar), është me rëndësi të konsultohen aktorët e ndryshëm për grumbullimin e të dhënave, analizën si dhe mbi rezultatet e analizës. Palët e interesuara për tu konsultuar mund të jenë vendimmarrësit, stafi zbatues, shfrytëzues të shërbimeve të jashtme, OJQ-të, etj. Konsultimi i gjerë do të lejojë që problemet të ngrihen "në terren" dhe që zgjidhjet e politikave të përpilohen në bazë të nevojave të përdoruesve të shërbimit ose përfituesve të drejtpërdrejtë të dokumentit strategjik. Duhet të ceket se në fazën e takimeve publike të cilat organizohen në fillim të hartimit të dokumentit strategjik, informatat dhe komentet e pranuar nga pjesëmarrësit në takim kontribuojnë në përkufizimin e problemit.

2.5.3 Krahasimi me vendet/komunat të tjera

Krahasimi me vendet e ngjashme apo me komunat të tjera në aspektin e zhvillimit ekonomik lokal është një hap i rëndësishëm të hartimit të strategjisë. Në këtë fazë grupi punues duhet të bëjë një analizë duke krahasuar çfarë probleme të ngjashme ekzistojnë në këto vende dhe çka janë ata zgjidhje të ofruar për këto probleme.

Krahasimi në këtë pjesë bëhet me fokus të veçantë në përvojat e vendeve që kanë ngjashmëri relevante për temën e dokumentit strategjik si dhe standardet ndërkombëtare ekzistuese. Në raste kur nuk mund të bëhet krahasimi me përvojën ndërkombëtare,

atëherë duhet të bëhet një përshkrim i shkurtër lidhur me arsyet pse ky problem është unik për këtë Komunë.

2.5.4 Analiza e problemit dhe mundësive për zgjidhje

Analiza e problemit mund të përdorë një numër të metodave dhe mjeteve ose të jetë një proces më intensive (dhe i thjeshtëzuar). Komplexiteti i analizës së problemeve do të varet nga kompleksiteti i problemeve dhe disponueshmëria e të dhënave dhe informatave mbi shkaqet dhe ndikimet. Një përmbledhje e faktorëve që kanë shkaktuar problemin ose kanë ndikim të madh në të duhet të jetë pjesë e rëndësishme të sfondit. Kjo përmbledhje duhet të bazohet në analizat e bëra gjatë zhvillimit të dokumentit strategjik (për shembuj, analiza SWOT dhe pema e problemit). Duhet gjithashtu të paraqiten aspekte se cilët prej këtyre faktorëve kanë ndikimin më të madh në problemin sipas analizave të realizuara.

2.5.4.1 Analiza SWOT

Analiza SWOT bëhet përmes sesioneve të shkëmbimit të ideve, punëtorive ose fokus grupeve që përfshijnë një gamë të gjerë të palëve të interesuara dhe përfaqësuesve nga organizatat e ndërlidhura. Do të nevojiten disa përgatitje paraprake për të bërë një analizë të suksesshme SWOT (për shembull, çështjet e lehtësimit, diskutimet paraprake me palët e interesuara dhe leximi mbi këtë temë). Rezultatet paraqiten në një tabelë SWOT e cila edhe përshkruhet në mënyrë narrative.

Përparësitë	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> ✚ Të gjitha informata duhet të merren nga të dhënat e mbledhura lidhur me përparësitë e komunës në aspektin e zhvillimit ekonomik lokal ✚ Ndërlidhja e këtyre përparësive me aktivitetet e propozuara janë të domosdoshme 	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Dobësitë e komunës po ashtu janë pjesë e problemeve të definuara më sipër. Për këtë arsyeje ndërlidhja logjike mes problemeve dhe dobësive është e rëndësishme për identifikimin e aktiviteteve të duhura për zbatim të strategjisë.
Rreziqet	Mundësitë

<p>✚ Rreziqet derivojnë nga problemet dhe dobësitë dhe çka mund të shkaktojnë ata. Gjithmonë në proces të listimit të rreziqeve, grupi punues duhet gjithashtu të mendojë mënyra të ndryshme për zvogëlimin e këtyre rreziqeve.</p>	<p>✚ Mundësitë e komunës janë ndërlidhura me kapacitetet ekzistuese të cilët janë burimet për zbatim të aktiviteteve të strategjisë.</p>
---	--

2.5.4.2 Analiza e pemës së problemit

Analiza e pemës së problemit është një metodë e rëndësishme për hartimin e dokumenteve strategjike. Pema e problemit nuk mund të jetë alternative për analizën SWOT dhe grupi punues mund të vendos të përdore atë gjatë procesit të përkufizimit të problemit si një mjet ndihmës. Pema e problemit duhet të përdoret si mjet ndihmës për identifikimin e aktiviteteve të cilët do të jenë pjesë e planit të veprimit.

Efektet

Efektet janë rezultat i problemit kryesor. Gjatë përkufizimit të problemit, grupi punues duhet të synoj të arrijë në një apo dy probleme kryesore të cilat duhet të adresohen për një zhvillim ekonomik lokal të qëndrueshëm e cila ndryshon jetën e qytetarëve dhe bizneseve për të mire. Nëse grupi punues vendos të përdore analizën e pemës së problemit, atëherë të gjitha efektet që derivojnë nga problemi/et kryesore duhet të listohen këtu.

Problemi Kryesor

Numri i problemeve kryesore varet prej kompleksitetit të fushës e cila analizohet. Në rastin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal grupi punues mund të vendos në disa probleme kryesore. Në këto raste efektet dhe shkaqet duhet të identifikohen për secilin problem ndaras.

Shkaqet

Shkaqet janë arsyeje kryesore pse problemet e listuar ekzistojnë. Në këtë rast ndërlidhja mes secilit shkak me secilin efekt është e domosdoshme për të arritur në zgjidhjet e problemit.

2.5.5 Përmbledhja e sfidave

Kjo pjesë duhet të përfshijë të gjitha informata që lidhen me sfidat sektoriale. Strategjia për zhvillim ekonomik lokal duhet të përfshijë informata dhe sfidat lidhur me fushat si më poshtë:

- ✚ Arsimi
- ✚ Infrastruktura
- ✚ Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale
- ✚ Bujqësia dhe Zhvillimi Rural
- ✚ Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore

Një përmbledhje se cilët nga shkaktarët e theksuar nuk mund të ndikohen fuqishëm nga veprimet e Komunës, dhe cilët janë jashtë fushëveprimit të dokumentit strategjik për shkak se adresohen në ndonjë dokument tjetër dhe një përmbledhje e veprimeve kryesore dhe të planifikuara me fonde të siguruara duhet të jenë po ashtu pjesë e këtij nën-kapitulli. Gjithashtu duhet të përfshijë veprimet kryesore partnerëve zhvillimorë dhe shoqërisë civile. Aktivitetet kryesore të planifikuara por të pa financuara duhet të përfshihen si opsione për t'u konsideruar. Mund të përdoren grafikë dhe imazhe për të ilustruar konstatimet e bëra, dhe të gjitha deklaratat duhet të mbështeten me të dhëna ose referenca përkatëse.

2.6 OBJEKTIVAT

Përcaktimi i objektivave për zhvillimin ekonomik të komunës është që t'i mundësojë komunitetit të artikulojë se ku dëshiron ai të jetë në të ardhmen, si e përfytyron ai këtë zhvillim dhe çfarë rrugësh mund të ndiqen për të shkuar tek ai zhvillim. Vizioni do t'ju japë qytetareve, por dhe vete qeverisjes lokale një ide të plotë se çfarë duhet bërë dhe ku duhen përqendruar burimet dhe energjitë e tyre. Përcaktimi i objektivave, ndihmon në vendim-marrjen lidhur me rrugët dhe mënyrat për të arritur ndryshimet që nevojiten.

Objektivi përgjithshëm paraqet një aspiratë më të përgjithshme së paku 5 vjeçare në formë të një deklarate rreth kushteve të preferuara që Komuna do të zotohet t'i arrijë. **Dokumentit strategjik nuk do të ketë më shumë se 5 objektiva strategjike të cilat do të lidhen me problemet e identifikuar dhe shkaqet e tyre.** Për të arritur qëllimin e identifikimit të 5 objektivave, komunat duhet të bëjnë analizën e përbërjes së objektivave

ku disa fusha mund të përfshihen në një objektive. Në rastet specifike 5 objektivat e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal mund të identifikohen për fusha a po fushat si më poshtë:

Objektivi Përgjithshëm 1: Arsimi

Objektivi Përgjithshëm 2: Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale

Objektivi përgjithshëm 3: Infrastruktura (duke përfshirë të gjitha shërbimet publike, ujësjellësin, kanalizimin, transportin etj.)

Objektivi Përgjithshëm 4: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Objektivi Përgjithshëm 5: Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore


Zbatimi i objektivit përgjithshëm do të operacionalizohet nëpërmjet objektivave specifike. Objektivi specifik specifikon rezultate më konkrete, duke u fokusuar më ngushtë në një aspekt të një fushe (ose numër fushash) të përcaktuar në një objektiv përgjithshëm, zakonisht me një perspektivë afatshkurtër (ose afatmesme). Në njërin anë, objektivat specifike janë të përcaktuara për të siguruar drejtime më të sakta për veprimet dhe secila duhet të arrihet përmes zbatimit të dy ose më shumë veprimeve. Në anën tjetër, ato duhet të lidhen me një objektiv të përgjithshëm dhe të paraqesin mjetet për ta arritur atë.

Për të arritur qëllimet Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal mbështetet në zhvillimin e burimeve të veta natyrore dhe njerëzore. Objektivat synojnë zhvillim dhe klimë për biznesin, por jo për kontrollin e tij. Zhvillimi i biznesit, pavarësisht qëndrimit të qeverisë lokale, është prosperitet. Problemi është ta orientosh zhvillimin e tij aty ku synon me objektivat e komunës.

Në dokumentin e Strategjisë duhet përfshihet një listë me jo më shumë se pesë objektiva të cilat: adresojnë problemin; adresojnë shkaktarët më të rëndësishëm të problemit, posaçërisht ata që aktualisht nuk janë duke u trajtuar nga aktivitetet ekzistuese ose të planifikuara (të financuara) qeveritare; një shpjegim të shkurtër përse këto objektiva janë përfshirë.

Objektivat e Strategjisë duhet të jenë:

- ✚ të lidhura drejtpërdrejt me problemet e identifikuara dhe shkaqet e tyre dhe të përpiqen t'i adresojnë ato;
- ✚ të harmonizuara mes vete;
- ✚ bazë për përcaktimin e treguesve.



Pra objektivat përgjithshme duhet të ndërlidhen me problemet kryesore, kurse objektivat specifike derivojnë nga shkaqet e problemit kryesore. Identifikimi i problemit dhe shkaqeve në përpikëri është e rëndësishme për hapin e identifikimit të objektivave përgjithshme dhe ato specifike.

Objektivat duhet të hartohen duke u bazuar në metodën SMART:

SPECIFIK - një objektivi duhet të jetë konkret, të përshkruaj rezultatin që duhet arritur, dhe i fokusuar, duke kontribuar në zgjidhjen e problemit;

IMATSHËM - një objektivi duhet të shprehet numerikisht dhe në aspektin sasior në lidhje me një standard specifike dhe duhet të lejojë që të përcillet progresi i zbatimit;

I ARRITSHËM/ REALIZUESHËM/ TË ORIENTUAR DREJT VEPRIMIT - një objektivi duhet të motivojë veprimin dhe duhet të theksojë se çfarë duhet të përmirësohet, rritet, forcohet etj., por duhet të jetë edhe i arritshëm;

REALIST - një objektiv duhet të jetë realist në aspektin e kohës dhe burimeve në dispozicion;

I KUFIZUAR BRENDA AFATEVE KOHORE - realizimi i objektivit duhet të specifikohet në aspektin e periudhës kohore.

2.6.1 Treguesit/ Aktivitetet

Objektivat përgjithshme dhe specifike duhet të shoqërohen me të paktën dy tregues për matjen e arritjes së objektivave. Në rastin e objektivit përgjithshëm, treguesi mund të vendoset në nivelin e ndikimit. Treguesit duhet gjithashtu të kenë vlerën bazë (gjendjen fillestare) dhe vlerat e synuara (caqet). Treguesit e dokumenteve strategjike duhet të kenë së paku 2 vlera të synuara (caqe) - synimin afatmesëm dhe synimin përfundimtarë - të vitit të fundit në përputhje me periudhën e zbatimit të dokumentit strategjik. Janë tri lloje të treguesve që mund të përdoren gjatë hartimit të planit të veprimit të Strategjisë:

- ✚ Treguesit e rezultateve konkrete (output), më saktësisht janë produktet që dalin nga zbatimi i aktiviteteve si p.sh. prodhimet, sasia etj.
- ✚ Treguesit e rezultateve të përgjithshme (outcomes), më saktësisht janë efektet që dalin nga zbatimi i aktiviteteve si p.sh. përmirësimi i sistemit të arsimit në një fushë.
- ✚ Treguesit e ndikimit (results) më saktësisht janë efektet afatgjatë që kanë ndikim në përmirësimin e jetës së qytetareve.

Specifikat më të rëndësishme që duhet të merren parasysh kur hartohet strategjia janë:

- ✚ Strategjia preferohet të ketë vetëm një problem kryesor;
- ✚ Strategjia preferohet të ketë 5 objektiva të përgjithshme më së shumti të cilat ndërlidhen me problemin kryesor;
- ✚ Strategjia preferohet të ketë së paku 3 objektiva specifike për secilin objektivë përgjithshëm të cilat derivojnë nga shkaqet e problemit kryesor;
- ✚ Secili objektiv specifik duhet të ketë së paku dy tregues/aktivitete;
- ✚ Treguesit e rezultatit konkret (output) janë treguesit që derivojnë nga objektivat specifike dhe përdoren për matjen e arritjes së caqeve;

- ✚ Treguesit e rezultateve përgjithshme (outcomes) janë treguesit që dalin nga zbatimi i objektivave të përgjithshme;
- ✚ Treguesit e ndikimit janë ata tregues që përdoren për matjen e efektit përgjithshëm kundrejt objektivave përgjithshme dhe përdoren në proces të raportimit për zbatim të strategjisë

2.7 MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal në periudhën 5 vjeçare ka edhe planin e vet të veprimit që mbulon periudhën 3 vjeçare i cili përbëhet nga aktivitetet, treguesit, institucionet përgjegjëse, kostot dhe caqet për arritje. Plani i veprimit të Strategjisë do të rishikohet në baza vjetore (sipas nevojës) në kuadër të planifikimit të monitorimit që përcaktohet në Strategji. Struktura për monitorimin e zbatimit të Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal përbëhet nga indikatorët matës, të cilët janë të vendosur në nivel të objektivave specifike në strategji. Gjate rishikimit objektivat e përgjithshme dhe objektivat specifike nuk mund të ndërrohen. Rishikimi nënkuptohet si ri-vlerësim i tregueseve dhe aktiviteteve të Strategjisë.

Komuna duhet të formoj grup punues për monitorimin e implementimit e planti të veprimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal. Në vendim të grupit punues duhet të ceken edhe afatet kohore për raportim dhe të dorëzohen në Kuvendin Komunal.

Monitorimi dhe raportimi i strategjisë duhet të bëhet kundrejt objektivave përmes tregueseve të vendosur. Raportimi duhet të përfundojë në tre mujorin e parë të vitit pasues dhe duhet të ketë informata lidhur me shkallën e zbatimit të tregueseve, problemet me zbatim dhe masat korrigjuese. Duket u bazuar në raportet e progresit të dokumenteve strategjike, dhe në bazë të sistemit të monitorimit, sipas nevojës bëhet rishikimi/vlerësimi i ndërmjetëm i planeve të veprimit.

2.8 NDIKIMI BUXHETOR

Vlerësimi i ndikimit buxhetor të Strategjisë është e domosdoshme sipas udhëzimit administrativ nr. 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit të gjitha institucionet qendrore dhe lokale. Për një Strategji sa më efektive, dhe për të zbatuar të gjitha aktivitetet të cilat do të kontribuojnë në arritjen e objektivave përgjithshme të strategjisë grupi punues duhet të plotësojë tabelën si më poshtë. Tabela më poshtë është përmbledhja e të gjitha kostove të strategjisë i cili përfshinë mbështetjen nga buxheti i komunës dhe mbështetjen nga donatorët dhe e shfaq një skenar realiste për arritje të objektivave. Kostoja duhet të jetë të harmonizuar me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH). Më tepër në tabelën e planit të veprimit, kostoja e secilit aktivitet dhe burimi i këtyre duhet të cekën specifikisht.

Përmbledhje e kostove të Strategjisë	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Mbështetja e zotuar me ekspertë			
Mbështetja e zotuar buxhetore (e harmonizuar me KASH)			
Mundësi potenciale financimi për donatorët			
Buxheti i Kosovës			
Totali			